



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 3329
Nr. 2234/3329 Akti
Vendimi

NR. VENDIMI 2710
Nr. 2710

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

Gjyqtar **Besnik HOXHA**

Me pjesmarjen e prokurorit **Enklid Gjini**, asistuar nga sekretare **Florinda Nushi**, sot me date 18-10-2021, mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore publike çeshtjen penale ne ngarkim:

TE PANDEHURIT: **Mustafa Idrizi**, i biri Luan-it dhe Klodianës, i datelindjes 16.07.2002, lindur dhe banues në rrugën “5 Maji” Tirane, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, me arsim të mesëm, i dënuar më parë, **me masë sigurimi “arrest në burg”**. Mbrojtur në gjykim nga Av.Dortila Cano me Nr.6199 license , caktuar kryesisht nga gjykata.

A K U Z U A R : Për veprën penale të **“Prodhimit dhe shitjes së narkotikeve”** parashikuar nga Neni 283/1 i Kodit Penal.

Gjykata pasi pranoi kërkesën për gjykim të shkurtuar, administroi provat, dëgjoi konkluzionet përfundimtare të Prokurorit, i cili kërkoi: **1.** Deklarimin fajtor të pandehurit **Mustafa Idrizi**, për veprën penale të **“Prodhimit dhe shitjes lendeve narkotike”**, parashikuar nga Neni 283/1 i K.Penal dhe denimin e tij me **5 (pesë) vjet burgim** si dhe aplikimin e nenit 406 te K.Pr.Penale;

Av. D.Cano, e cila kërkoi dënimin e të pandehurit Mustafa Idrizi nën minimumin e parashikuar në ligj; I pandehuri M.Idrizi, dakort me avokaten; si deklaroi të mbyllyr shqyrtimin gjyqësor dhe bisedoi çështjen në tërësi .

V E R E N se:

Se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë i është drejtuar Gjykatës me kërkesën Nr.2234 Akti, datë 06.08.2021 regjistrimi me objekt : Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal Nr.3959/2021 në ngarkim të pandehurit Mustafa Idrizi, akuzuar për veprën penale të **“Prodhim, shitje të lëndëve narkotike”**, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal duke i bashkalidhur kërkesës edhe aktet dhe provat që përmban fashikulli për gjykim.

Me vendimin Nr.2234 akti, dt. 06.08.2021, të gjyqtarit të seances paraprake është vendosur që çështja të dërgohet për gjykim.

Në seancën paraprake i pandehuri kërkoi gjykim të shkurtuar në bazë të neneve 332/c/3 dhe 403 të K.Pr.Penale.

Gjykata pasi degjoi parashtrimin e prokurorit, e pranoi kerkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar në baze të nenit 405/6 të K.Pr.Penale, pasi çmon se çështja zgjidhet në gjëndjen që janë aktet dhe zhvilloi gjykimin sipas kërkesave të këtij neni, pra duke u bazuar në gjëndjen që janë aktet.

Megjithate ka rezultuar plotesisht e provuar se :

Më date 01.06.2021, rreth ores 19:20, punonjësit e policisë së Sektorit të forcës së posacme "Shqiponja", duke patrulluar në ambjentet e Spitalit Ushtarak kanë parë dy persona, te cilet quheshin Mustafa Idrizi dhe Denis Gjana. Në moment që janë afruar punonjesit e policise këta dy shtetas kanë filluar të bëjnë lëvizje të dyshimta. Gjatë kontrollit të shtetasit Mustafa Idrizi, në xhepin e bluzës i është gjendur një qese e verdhë, brenda së cilës kishte material bimor me aromë dhe karakteristika si ajo e lëndës narkotike Cannabis Sattiva. Për këtë arsye është bërë shoqërimi i të dy personave në ambjentet e policisë.

Pasi u be sekuestrimi i lëndës së dyshuar narkotike të llojit Cannabis Sativa u bë peshimi i saj dhe rezultoi me peshë të përgjithshme me amballazh 6.8 (gjashte pike tete) gram, e cila pas peshimit u fut në qesen e provave me Nr.UNIK. A20002429.

Shtetasi Mustafa Idrizi është pyetur në cilësin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime për veprën penale "*Prodhim dhe shitje narkotikesh*", parashikuar nga neni 283 / 1 i K. Penal dhe ka deklaruar se lënda narkotike që i është gjetur me vete është e tij, e ka pasur për përdorim vetjak, pasi është përdorues i lëndës narkotike prej rreth 2 vitesh.

Pasi u be sekuestrimi i lendes se dyshuar narkotike te llojit Cannabis Sattiva u bë peshimi i saj dhe rezultoi me peshe të përgjithshme me amballazh 6.8 (gjashte pike tete) gram, e cila pas peshimit u fut në qesen e provave me Nr.UNIK. A20002429.

Sipas Aktit të ekspertimit kimik të materialit bimor të sekuestruar me Nr.5859 dt.17.06.2021 ka rezultuar se pesha e materialit bimor pa ambalazh është 4.999 gr. është produkt herbal bime cannabis sativa L.

Po kështu me aktin toksikologjiko - ligjor nr.1256 dt. 10.06.2021 ka rezultuar se "*në urinën e shtetasit Mustafa Idrizi nuk u zbulua prania e produkteve të kanabinoidike të metabolizmit të bimës cannabis sativa L në organizmin e njeriut*".

Në këto rrethana i pandehuri Mustafa Idrizi nuk është përdorues i lëndës narkotike, por ai e mbante në mënyrë të kundraligjshme lëndën narkotike , mbi bazën e të cilave lind dyshimi se ai u shet lëndë narkotike personave të ndryshëm, të gjitha këto indicje janë të rëndësishme dhe në pëputhje me njëra tjetrën për të nxjerrë ekzistencën e faktit që lënda narkotike mbahej nga i pandehuri me qëllim për ta shitur.

Akuzat në ngarkim të pandehurit Mustafa Idrizi janë provuar si gjate hetimeve paraprake ashtu edhe në séance gjyqesore me administrimin e proces-verbalit të sekuestrimit të provës materiale dt.01.06.2021, proces-verbal i arrestimit në flagrancë dt.01.06.2021, akt – ekspertimi kimik i lëndës Nr.5859 dt.17.06.2021, akti ekspertimit toksikologjik-ligjor nr.1256 dt.10.06.2021, proces verbal i kontrollit të vendeve në banesën e shtetasit

M.Idrizi dhe në tërësi aktet të ndodhura në fashikullin e procedimit penal Nr.3959 te vitit 2021, të cilat si u moren për shqyrtim u administruan në dosje dhe që në referim të **vendimit unifikues te Gjykates se Larte, nr. 2, date 29.01.2003, duke zbatuar gjykimin e shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet ne dosje gjyqesore.**

Për sa më sipër gjykata cmon se i pandehuri ka konsumuar plotesisht elementet e veprës penale, për të cilën ai akuzohet. Kështu si subjekt i veprës penale është i pandehuri Mustafa Idrizi. Ai është madhor dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale për veprën e kryer.

Gjate hetimit si dhe gjate këtij gjykimi, asnje dyshim nuk është shfaqur, ai është i përgjegjshëm për të kuptuar se po shkelte ligjin penal shqiptar, duke mbajtur dhe shitur lëndë narkotike. Nga pikepamja e anës subjektive, i pandehuri ka vepruar me dashje të drejtpërdrejt, me qëllim mbajtjen, shitjen dhe shpërndarjen e lëndës narkotike .

Objekti i veprës penale që ka kryer i pandehuri Mustafa Idrizi janë marrëdhëniet juridike të vecanta të vendosura në ligjin penal, me qëllim për të siguruar jetën dhe shëndetin e njerëzve, e cila gëzon nje mbrojtje të vecante nga legjislacioni ynë penal. Në rastin konkret objekt i këtij gjykimi, Gjykata krahas vështrimit të përgjithshëm dhe teorik qe parashikohet për këto vepra penale, mban në konsiderate dhe cmon edhe subjektin e kësaj vepre penale si dhe rrethanat e kryerjes së saj.

Megjithatë në llojin dhe masën e dënimit ndaj këtij të pandehuri Gjykata mban parasysh sic u spjegua dhe me lart, rrethanat rënduese dhe lehtësuese për të . Keshtu Gjykata krahas rrethanave rënduese qe parashikon kryerja e veprës penale mban parasysh si rrethana lehtesuese për të pandehurin faktin që ai tregoi pendim të thelle, moshën e tij etj.

Nisur nga sa më siper gjykata cmon se lloji i dënimit i kërkuar nga prokurori është i përshtatshëm për këta të pandehur.

PER KETO ARSYE:

Mbeshtetur ne nenet 384 e 390 te Kodit Pr. Penale Gjykata

V E N D O S I:

1.Deklarimin fajtor të pandehurit **Mustafa Idrizi**, për veprën penale të *“Prodhimit dhe shitjes të narkotikeve”*, parashikuar nga neni 283/1 K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite e dënon atë me **5 (pesë) vjet burgim** .

- Në aplikim te nenit 406/1 K.Pr.Penale mases se mesiperme i zbritet 1/3 e saj dhe përfundimisht e dënon të pandehurin **Mustafa Idrizi**, me **3 (tre) vjet e 4 (kater) muaj burgim** .

- Vuajtja e dënimit fillon nga dt.01.06.2021 dita arrestimit në flagrancë, duke urdhëruar qe kjo vuajtje te kryhet ne nje nga Burgjet e Sigurise Zakonshme.

-Në baze te nenit 190/1 pika "c" K.Pr.Penale provat materiale te sekuestruara, lënda narkotike të asgjësohet .

-Shpenzimet gjyqesore dhe ato proceduriale i ngarkohen të pandehurit.

- Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë,

duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.
U shpall sot me Tiranë datë 18-10-2021.

**SEKRETARE
GJYQTARI**

**Florinda
Besnik HOXHA**

NUSHI

SHPENZIMET GJYQESORE
Taksa njoftimit 4x150 leke
Taksa avokatit 4 000 leke
Shpenzimet procedurale nuk ka te evidentuar